



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-144

PËR STANDARDIZIMIN

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Ne mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR STANDARDIZIMIN

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj përcaktohen rregullat për zhvillimin e të gjitha veprimtarive të standardizimit në nivel të Kosovës, si dhe organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kosovare të Standardizimit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për standardet e hartuara, të njohura, të miratuara, të adaptuara për fushën e ekonomisë, të metrologjisë dhe të industrisë.
2. Ky ligj nuk zbatohet për standardet e hartuara, të adoptuara dhe të miratuara të fushës së telekomunikacionit, si dhe të specifikimeve të ndryshme për nevoja interne.

Neni 3 Përkufizime

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Standardizim** - veprimtari vullnetare si rezultat i një konsensusi të realizuar nga dhe për vetë palët e interesuara që ka të bëjë me proceset e përgatitjes, publikimit dhe zbatimit të standardeve bazuar në gjithë përfshirje dhe transparencë;

1.2. **Agjencia Kosovare e Standardizimit – AKS** - institucion i standardizimit, i njohur në Republikën e Kosovës, i themeluar me ligj, i cili gëzon të drejtën e përfaqësimit kosovar në organizatat homologe, rajonale dhe ndërkombëtare;

1.3. **Organizata ndërkombëtare e standardizimit** - organizatë standardizimi, (ISO) anëtarësimi në të cilin është i hapur për organet kombëtare përkatëse të çdo vendi;

1.4. **Organizatave evropiane të standardizimit** - Komiteti Evropian i Standardizimit (CEN), Komiteti Evropian i Standardizimit në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI);

1.5. **Standard** - dokument vullnetar i hartuar me konsensus dhe i miratuar nga një organ i njohur standardizimi, i cili ofron për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtari apo rezultatet e tyre, për një shkallë optimale rregulli, në një kontekst të dhënë;

1.6. **Standard ndërkombëtar** - standard i cili është adoptuar nga një Organizatë Ndërkombëtare Standardizimi dhe që i është vënë në përdorim publikut;

1.7. **Standard evropian (EN)** - standard vullnetar, i adoptuar nga njëra prej organizatave evropiane të standardizimit dhe që i është vënë në përdorim publikut;

1.8. **Dokument harmonizimi (HD)** - dokument normativ vullnetar, i adaptuar nga njëra prej organizatave evropiane të standardizimit, me detyrimin e zbatimit të përmbajtjes teknike në Kosovë dhe shfuqizimin e standardeve të adaptuara kosovare e të dokumenteve normative kosovare, që bien ndesh me ato evropiane;

1.9. **Standard i harmonizuar** - çdo standard evropian (EN) ose një dokument harmonizimi (HD) i adoptuar nga njëra prej organizatave evropiane të standardizimit, në zbatim të mandatit të lëshuar nga Komisioni Evropian, pas këshillimeve me vendet anëtare, numrat e referencës të të cilit publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian;

1.10. **Standard kosovar** - dokument i miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe shënohet me (S K);

1.11. **Standard kosovar i harmonizuar** - çdo standard kosovar që ka adoptuar një standard evropian të harmonizuar, sipas rregullave teknike;

1.12. **Dokument standardizimi** - dokument i miratuar nga organet evropiane, ndërkombëtare dhe i adoptuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), siç janë specifikimet teknike, raportet teknike, manuallet apo marrëveshjet e veçanta teknike, i cili është vënë në përdorim të publikut;

1.13. **Programi i punës së standardizimit** - program pune i Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS), i cili përmban elementet e veprimtarisë së standardizimit për një periudhë të caktuar kohore;

1.14. **Këshill Profesional i Standardeve (KPS)** organ këshillëdhënës nga palët e interesit;

1.15. **Komitet teknik** - grupe ekspertësh vullnetarë që veprojnë në fusha të caktuara të standardizimit;

1.16. **Kodi i praktikës së mirë** - dokument udhëzues që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare dedikuar organeve standardizuese;

1.17. **Referim tregues ndaj standardeve** - referim ndaj standardeve, i cili përcakton se njëra nga mënyrat, për të përmbushur kërkesat përkatëse të një rregulli teknik, është zbatimi i standardit, referuar në aneksin e rregullit;

1.18. **Subjekt** - person fizik dhe juridik;

1.19. **Palë e interesit** - person juridik ose fizik (Universiteti, Oda Ekonomike, kompania private, Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit, shoqata e biznesit dhe përfaqësuesi i mbrojtjes së konsumatorit) që gjendet në një raport të caktuar me institucionin përkatës të standardizimit.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë kosovare të standardizimit

1. Parimet e veprimtarisë kosovare të standardizimit janë:

1.1. e drejta e pjesëmarrjes vullnetare e palëve të interesuara në procesin e hartimit, miratimit dhe adoptimit të standardeve kosovare, si dhe në zbatimin vullnetar të tyre;

1.2. konsensusi i palëve të interesuara për përmbajtjen e standardeve kosovare;

1.3. transparenca në të gjitha fazat e veprimtarisë së standardizimit, përmes publikimit e informimit të publikut;

- 1.4. parandalimi, që interesat individualë të mbizotërojnë ata të përgjithshëm;
- 1.5. pjesëmarrja në punën evropiane e ndërkombëtare të standardizimit, zbatimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si standarde kosovare.

Neni 5

Fushëveprimtaria e standardizimit

1. Fushë veprimtaria e standardizimit ka për qëllim të:

- 1.1. rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë së shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar rregulla të përbashkëta;
- 1.2. promovojë cilësinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve të ndryshme sipas standardeve të caktuara;
- 1.3. sigurojë shfrytëzim racional të materialeve dhe të energjisë, si dhe efikasitet në punë;
- 1.4. ndihmojë për heqjen e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare.

Neni 6

Identifikimi i standardeve kosovare

1. Standardet kosovare identifikohen me emërtim shkronjash dhe numrash;

1.1. emërtimi do të përmbajë shkronjat “S K” apo një ndërthurje të shkronjave “S K” me shkronja të tjera, sipas origjinës, në rastet e zbatimit të standardeve evropiane ose ndërkombëtare.

1.2. pjesa numerike përmban numrin e standardit dhe vitin e miratimit të tij.

2. Këto emërtime nuk përdoren për standarde të tjera, që krijohen nga shoqata apo entitete të tjera në Republikën e Kosovës, përveç Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS).

Neni 7

Zbatimi i standardeve kosovare

1. Zbatimi i standardeve kosovare është vullnetar.

2. Standardet kosovare janë të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës.

3. Një rregull teknik, i cili përmban kërkesa thelbësore, mund t'u referohet standardeve kosovare ose pjesëve të tyre vetëm atëherë kur ky rregull teknik merret nga direktiva të Bashkimit Evropian. Referimi ndaj këtyre standardeve duhet bërë si "Standarde kosovare të harmonizuara".
4. Standardet kosovare të harmonizuara, të miratuara nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) pas këshillimeve dhe me propozimin e ministrive dhe të autoriteteve të tjera ekzekutive, i propozohen Qeverisë për miratim me listë gjegjëse të rregullave teknike. Lista e standardeve kosovare të harmonizuara, si dhe çdo rishikim i tyre publikohet në Gazetën Zyrtare. Çdo referim ligjor ndaj standardeve kosovare të harmonizuara do të ketë karakter tregues.
5. Ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor të cilat përgatisin rregulla teknike që përmbajnë referime ndaj standardeve kosovare ose pjesëve të këtyre standardeve për zbatim në nivel të Kosovës, bashkëpunojnë me Agjencinë Kosovare të Standardizimit (AKS) për mënyrën e referimit.
6. Një rregull teknik do t'u referohet standardeve kosovare, të cilat njohin, adoptojnë standarde evropiane ose ndërkombëtare, vetëm nëse këto standarde janë adoptuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) dhe janë publikuar si standarde kosovare në njërën nga dokumentet e saj.

Neni 8

Agjencia Kosovare e Standardizimit

1. Agjencia Kosovare e Standardizimit është organ kombëtar i standardizimit në Republikën e Kosovës për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë, me përjashtim të atyre të fushës së telekomunikacionit.
2. Standardet e fushës së elektroteknikës janë përgjegjësi e komitetit të elektroteknikës, i cili funksionon brenda Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) .
3. Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
4. Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) drejtohet nga Kryeshefi, që emërohet dhe shkarkohet sipas ligjit në fuqi.
5. Struktura organizative e Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) rregullohet me akt nënligjor.

Neni 9

Përfaqësimi

Agjencia Kosovare të Standardizimit (AKS) përfaqëson Republikën e Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC), në Komitetin Evropian të Standardizimit (CEN) dhe në Komitetin Evropian për

Standardizimin në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standardet.

Neni 10 **Këshilli Profesional i Standardizimit**

1. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS) është organ këshillëdhënës i përbërë nga palët e interesit dhe funksionon në kuadër të Agjencisë Kosovare të Standardizimit.
2. KPS trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e Komiteteve Teknike.
3. Në KPS marrin pjesë përfaqësues nga palët e interesuara për standardizimin.
4. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS) harton rregulloren e vet të punës dhe zgjedh kryesuesin me shumicë votash të anëtarëve.

Neni 11 **Komitetet teknike**

1. Komitetet teknike janë grupe ekspertësh të standardizimit që nuk bëjnë pjesë në strukturat e brendshme të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe angazhohen për fusha të caktuara të standardizimit.
2. Komitetet teknike krijohen dhe shpërbëhen me propozim të Këshillit profesional të Standardizimit (KPS) dhe vendim të Kryeshefit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS).
3. Pjesëmarrja në komitetet teknike është vullnetare dhe e hapur për të gjitha palët e interesit.

Neni 12 **Anëtarësimi**

1. Çdo person juridik ose fizik, që ushtron veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës, ka të drejtë të anëtarësohet në Agjencinë Kosovare të Standardizimit (AKS-së).
2. Të drejtat, detyrimet dhe kuota e anëtarësimit përcaktohen me marrëveshje me palët e interesuara

Neni 13

Kompetencat

1. Agjencia Kosovare e Standardizimit ushtron këto kompetenca:

1.1. harton dhe miraton rregullat dhe procedurat e punës për veprimtaritë e standardizimit, në zbatim të veprimtarive të organizatave evropiane të standardizimit;

1.2. përgatit, miraton dhe publikon programin e punës së standardizimit, në përputhje me interesat e palëve.

1.3. harton, njeh, adopton, miraton, zbaton, ndryshon, shfuqizon dhe publikon standardet kosovare dhe dokumentet kosovare të standardizimit;

1.4. zbaton parimet dhe rregullat e ndjekura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;

1.5. përgatit dhe mirëmban bazën e të dhënave për standardet;

1.6. përgatit dhe mirëmban arkivin me standarde kosovare, evropiane, ndërkombëtare, si dhe kryen shitjen e tyre sipas ligjit në fuqi;

1.7. ofron shërbime informacioni për subjektet afariste të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj;

1.8. zbaton detyrimet si Pikë Referimi, të cilat rrjedhin si rezultat i marrëveshjes me CEFTA-n/OBT për barrierat teknike në tregti dhe të kodit të praktikës së mirë për hartimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve;

1.9. zbaton detyrimet që rrjedhin nga direktiva 98/34/EC e BE-së, datë 22 qershor 1998, të ndryshuar 98/48/EC dhe Direktiva 2006/96 EC “Për dhënien e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike dhe rregullave për shërbimet e informimit të shoqërisë”;

1.10. shkëmben informacion dhe bashkëpunon në fushën e standardizimit me organe kombëtare të standardizimit të vendeve të tjera;

1.11. organizon trajnime dhe veprimtari për standardizimin;

1.12. publikon buletin dhe katalogun e standardeve kosovare brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik.

1.13. inicon studimet, publikimet, përvojën dhe punën kërkimore për standardizimet, si dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me standardizimin;

Neni 14

Hartimi, adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve kosovare

1. Çdo subjekt mund t'i paraqesë Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) një propozim, të shoqëruar me arsyetimin përkatës, për hartimin, adoptimin dhe miratimin e një standardi kosovar.
2. Procedura e hartimit, adoptimit dhe miratimit të standardeve kosovare duhet të përcaktojë:
 - 2.1. objektivat që duhen arritur nga standardi i propozuar;
 - 2.2. faktorët dhe ndikimin ekonomik;
 - 2.3. burimet e financimit dhe të ekspertizës;
 - 2.4. zbatimet e mundshme të standardit, në kuadër të vlerësimit të Konformitetit;
 - 2.5. lidhjet me standardet e tjera.
3. Standardet evropiane dhe ndërkombëtare janë të gatshme për përdorim publik, përmes njohjes dhe adoptimit të tyre si standarde kosovare.
4. Standardet evropiane e ndërkombëtare zbatohen në të njëjtën mënyrë si standarde kosovare përmes:
 - 4.1. njohjes, adoptimit, miratimit dhe përgatitjes së një teksti të njëjtë me origjinalin e standardit në gjuhët zyrtare;
 - 4.2. hartimit të faqes së parë në gjuhët zyrtare;
 - 4.3. miratimit me listë si standarde kosovare.
5. Konfirmimi i miratimit si standarde kosovare bëhet përmes përgatitjes së një dokumenti zyrtar miratimi, si dhe me shpalljen në buletin periodik të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) .
6. Me njohjen, adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde kosovare, çdo standard kosovar apo akt tjetër normativ, që bie ndesh me ato evropiane shfuqizohet.
7. Procedura për njohjen, adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde kosovare përcaktohet në rregullat dhe procedurat për veprimtaritë e standardizimit, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.
8. Hartimi, njohja apo adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve kosovare bëhen në përputhje me rregullat dhe procedurat për veprimtaritë kosovare të standardizimit.

Neni 15

Hartimi, adoptimi dhe miratimi i dokumenteve kosovare të standardizimit

1. Dokumentet kosovare të standardizimit hartohen, adoptohen dhe miratohen sipas rregullave dhe procedurave për veprimtaritë kosovare të standardizimit.
2. Dokumentet kosovare të standardizimit identifikohen përmes emërimit me shkronja dhe numra:
 - 2.1. emërtimi me shkronja përbëhet nga shkronjat “DS” (Dokument standardizimi), ose në një kombinim të shkronjave DS dhe emërtime të tjera me shkronja, në rastet e njohjes apo adoptimit të dokumenteve evropiane ose ndërkombëtare të standardizimit.
 - 2.2. emërtimi numerik përbëhet nga numri i dokumenteve të standardizimit dhe viti i miratimit apo adoptimit të tyre. Këto emërtime nuk do të përdoren për dokumente të tjera standardizimi përveç dokumenteve kosovare të standardizimit.

Neni 16

Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i standardeve kosovare dhe i dokumenteve kosovare të standardizimit

1. Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) kontrollon periodikisht dhe konfirmon statusin e standardeve kosovare.
2. Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i një standardi kosovar apo i një dokumenti kosovar të standardizimit realizohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e veprimtarive kosovare të standardizimit.

Neni 17

E drejta e autorit dhe e drejta e shitjes

1. E drejta e autorit për formën, përmbajtjen dhe e drejta e shitjes për çdo standard kosovar apo dokument tjetër standardizimi i takon Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS).
2. Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) ka të drejtën ekskluzive për botimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e projekt standardeve dhe standardeve kosovare, të projekt dokumenteve dhe të dokumenteve kosovare të standardizimit.

Neni 18
Burimet e financimit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS)

1. Të ardhurat buxhetore të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) sigurohen nga:

- 1.1. buxheti i Kosovës;
- 1.2. pjesëmarrja në programe donatorësh dhe/ose projekte, që kanë qëllime të caktuara financimi, qofshin këto evropiane, ndërkombëtare apo të çdo lloji tjetër;
- 1.3. donacione apo grante nga subjektet fizikë dhe/ose juridikë;

Neni 19
Dispozitat ndëshkuese

1. Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) ka të drejtë ta iniciojë procedurën gjyqësore kundër personit fizik ose juridik, që ushtron aktivitet në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji.
2. Masat ndëshkimore shqiptohen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal.

Neni 20
Dispozitat kalimtare

1. Standardet kosovare, të emëtuara me shkronjat “S K”, të cilat janë miratuar, njohur apo adoptuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji e ruajnë vlefshmërinë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të nxjerr akte nënligjore.

Neni 21
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen Ligji nr. 2004/12 “Për Standardizimin” dhe Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 2004/12 “Për Standardizimin”, nr. 02/L-83 si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-144
30 shtator 2009

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI